



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.03/2017

Prishtinë, më 8 nëntor 2017

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Miljana Nikoliq, Frashër Krasniqi, Mytaher Haskuka, Saranda Bogujevci, Mirjeta Kalludra, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj dhe Albulena Balaj-Halimaj.

Mungoi: Teuta Haxhiu.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Hajredin Skënderi-Ambasada e Zvicërës; Teuta Prekazi-UN “Human Rights”; Flora Kryeziu-UNICEF dhe Merita Mustafa-Qendra për Fuqizimin e Gruas.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Kryetarja njoftoi anëtarët e komisionit se Grupi për Studime Juridike dhe Politike, ka kërkuar që takimi me Komisionin funksional të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e Komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit;
2. Shqyrtimi Propozim-planit të punës së Komisionit funksional për vitin 2017;
3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të Avokatit të Popullit lidhur me trajtimin e punëve të pambaruara nga legjislatura e kaluar, sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës;
4. Shqyrtimi i peticioneve;

5. Takim i anëtarëve të Komisionit funksional me përfaqësues të organizatës- Qendra për Fuqizimin e Gruas;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit

Saranda Bogujevci, tha se kur është votuar për miratimin në parim të Projektligjit për ndryshim plotësimin e Ligjit për lirinë fetare në Kosovë, është dashur të ceket në rekomandim të Komisionit funksional, për seancën plenare, që ky projektligj shkon në lexim të parë, me vërejtjet e përmendura në diskutim nga shqyrtimi i projektligjit në Komisionin funksional.

Duda Balje, tha se pas leximit të parë në seancë plenare, pra kur jemi në fazën e amendamentimit të projektligjit, e deri në leximin e dytë në Kuvend, kemi mundësi edhe si komision edhe si deputetë të bëjmë propozim-amendamente.

Saranda Bogujevci, tha se kërkoj të ceket në procesverbal që e kemi pasur atë kërkesë.

Selman Ymeri, koordinator i komisionit, dha sqarime për shqyrtimin e projektligjit në parim, në Komisionin funksional.

Frashër Krasniqi, tha se është mirë që të evidentohet kjo çështje.

Kryetarja, konstatoi se nëse deputetët në fjalë kanë vërejtje konkrete, të plotësohen në procesverbal.

2. Shqyrtimi Propozim-planit të punës së Komisionit funksional për vitin 2017

Duda Balje, theksoi se para vetes kemi Propozim-planin e punës, i cili është një plan dymujor, me siguri e keni analizuar dhe më pas hapi debat lidhur me këtë pikë.

Frashër Krasniqi, tha se nuk e di a është kohë e mjaftueshme, por është mirë të parashihet edhe formimi i një grupi të punës, sepse ka qenë një grup për të nxjerrë një udhëzues për shqyrtimin e peticioneve ose të jetë si punë nismëtare, për nxjerrjen edhe të një ligji për shqyrtimin e peticioneve. Jam i gatshëm të përfshihem në këtë grup apo të vazhdohet puna aty ku ka mbetur ose të fillohet nga e para.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se ishte kryesuese e grupit të punës për shqyrtimin e udhëzuesit për peticionet, kemi pasur punëtori e grupe punuese dhe kemi punuar aq shumë në të dhe si komision e kemi finalizuar, por në takimet e Komisionit për Legjislacion dhe komisionit tonë, është sugjeruar që kjo të bartet në Propozim-rregulloren e re të Kuvendit, kurdo që një punë e tillë mund të vazhdojë.

Frashër Krasniqi, tha se a mundemi ta kemi atë udhëzues para se ai të hyjë në Rregulloren e re të Kuvendit, që nëse kemi diçka, të mund të ndryshojmë apo të shtojmë.

Mexhide Mjaku Topalli, tha se udhëzuesi është i finalizuar.

Saranda Bogujevci, tha se sa i përket hapjes së fushatës për aktivizimin kundër dhunës në familje, nuk janë çekur detajet se si është paraparë kjo çështje.

Duda Balje, tha se pritet të organizohet ky aktivitet, ndërsa për detaje do të vendosim së bashku në komision.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se angazhohet për takimin e komisionit me Agjencinë për Barazi Gjinore, por propozoi që të mbahet edhe një tryezë me të gjithë aktorët që merren me mbrojtjen nga dhuna në familje dhe të diskutojmë për ngritjen e vetëdijes, për situatën aktuale dhe bashkëpunimin institucional.

Luljeta Veselaj, tha se OSBE është e gatshme të kontribuojë, sepse kanë bërë më shumë punë dhe disa hulumtime në këtë drejtim.

Do të ishte mirë që të ftohen edhe zyrtaret e barazisë gjinore të disa komunave, por edhe të OSBE-së.

Mexhide Mjaku-Topalli, diskutoi lidhur me aktivitet që parashihen të mbahen për shënimin e Ditës Ndërkombëtare për Persona me Aftësi të Kufizuara dhe tha se çka do të bëjmë në mënyrë konkrete për shënimin e kësaj dite. Ajo tha se do të ishte mirë të organizohet një konferencë ku do të ftoheshin edhe përfaqësues nga komisionet parlamentare gjegjëse të vendeve të rajonit.

Saranda Bogujevci, pyeti se a ka mundësi të mendojmë pak për këtë temë dhe të dërgohen rekomandimet tona përmes e-mailit.

Kryetarja, tha se në fillim të dhjetorit të parashihet edhe mbajtja e kësaj tryeze dhe konstatoi se plani i punës u miratua me këto plotësime të bëra sot në mbledhjen e komisionit.

3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të Avokatit të Popullit lidhur me trajtimin e punëve të pambaruara nga legjislatura e kaluar, sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryetarja, tha se Avokati i Popullit ka hasur disa probleme në zbatimin e Rregullores së Kuvendit, përkatësisht nenin 86, ku në të tri gjuhët, shqipe, serbe dhe angleze, ka mospërputhje.

Frashër Krasniqi, tha se çështjen që ka ngritur Avokati i Popullit, ka të drejtë, sepse punët që mbesin nga mandati i kaluar, në bazë të interpretimit të rregullores, nisin prej fillimit në mandatin aktual. Kjo në disa raste është e nevojshme në disa jo, sepse bëhet zvarritja e punëve, dhe ndoshta ne kemi mundësi ta shtyjmë këtë proces përpara, sepse kjo lë mundësi të ndryshme interpretimi dhe nuk specifikon saktë çka duhet bërë.

Në emër të komisionit tonë, është mirë që këtë propozim t'ia paraqesim Komisionit për Legjislacion.

Mytaher Haskuka, edhe legjislaturën e kaluar kemi pasur projektligje të proceduara dy herë e kështu me radhë. Projektligji për lirinë fetare është që tri legjislatura në procedurë. Është e

pakuptimtë një projektligj që ka kaluar në procedurat parlamentare, të kthehet prej fillimit, në legjislaturën e re.

Është normale që me ndryshimin e Qeverisë ndryshojnë politikat dhe kërkohet edhe ndryshimi i ligjit, varësisht nga politikat që i kanë, por në rast se Qeveria nuk kërkon që një projektligj të kthehet mbrapa, atëherë të vazhdohet me atë projektligj.

Si shembull, në këtë aspekt ai mori Projektligjin për mbrojtjen e fëmijës, ku kemi punuar një kohë mjaft të gjatë, pastaj është rekomanduar për miratim në Kuvend, por për shkak të shpërbërjes së legjislaturës së kaluar, nuk ka arritur të miratohet në Kuvend.

4. Shqyrtimi i peticioneve

Shqyrtimi i petitionit të banorëve të fshatit Orllan, KK- Podujevë

Duda Balje, tha se në shqyrtim kemi petitionin e banorëve të fshatit Orllan me rrethinë, KK- Podujevë, të cilët kanë problem me ujin e pijes dhe çështje të realizimit të ujësjellësit.

Frashër Krasniqi, tha se është mirë që sa herë të kemi në shqyrtim petitionet, të jenë të ftuara

palët që janë të involvuar me atë petition, sepse nga aty del serioziteti i komisionit dhe marrim informatat e duhura dhe mund të nxjerrim përfundime të vlefshme.

Ujin që ata kanë në dispozicion është jociësor dhe jo i pijshëm. Specifika e dytë është se në tokat e kësaj zone ndodhet rezervuari që i furnizon thuhetse 600 000 banorë me ujë të pijes. Meqenëse nuk është miratuar ende buxheti për vitin 2018, urgjentisht këtë petition ta vendosim si pikë të veçantë në seancë plenare të Kuvendit dhe të kërkohet nga Qeveria që ta përfshijë zgjidhjen e këtij problemi, si pjesë të buxhetit për vitin 2018. Ai kërkoi që të hedhet në votim propozimi i tij.

Duda Balje, tha se kemi mundësi t'i drejtohem me një shkresë Drejtorisë për Shërbime Publike të Komunës së Podujevës, pasi që kjo është një problem i komunës.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se është një kohë prej se është parashtruar ky petition dhe fillimisht është mirë të marrim informata nëse mos është ndërmarrë ndonjë veprim drejt zgjidhjes së këtij problemi.

Edhe në mandatin e kaluar, gjatë shqyrtimit të peticioneve, kemi ftuar palët në mbledhje të komisionit. Sa i përket kësaj lënde, është mirë të ftohen personat kompetentë nga Komuna e Podujevës dhe përfaqësuesit e petitionit dhe të diskutojmë, nëse deri më tash nuk është ndërmarrë ndonjë veprim konkret.

Saranda Bogujevci, ne si komision mund të bëjmë presion tek institucionet që merren me këto çështje dhe jam e pajtimit që kjo çështje të ngrihet në Kuvend dhe të jemi zë i qytetarëve për kërkesat e tyre.

Luljeta Veselaj, tha se fillimisht është mirë t'i ftojme në komision palët dhe Komunën e Podujevës, pasi të na informojnë për gjendjen dhe t'i shterojmë të gjitha mundësitë, dhe nëse nuk mbeten zgjidhje tjera, pastaj të shikojmë mundësitë për zgjidhje të tjera.

Lirije Kajtazi, tha se varësisht prej rasteve, gjatë shqyrtimit të peticioneve, kemi praktikuar që palët të jenë prezent në komision, por për këto vendosim bashkë. Sa i përket këtij peticioni, në pranverë kam takuar z. Rexhep Zekën, përfaqësues i banorëve nënshkrues të peticionit dhe ka deklaruar se i ka provuar disa biseda me komunën, pastaj me telefon kam kontaktuar edhe me Komunën e Podujevës dhe kanë deklaruar se janë në proces të gjetjes së zgjidhjes. Më e mira është me një shkresë të kërkojmë nga komuna të na informojë se çka është bërë në këtë drejtim, sepse këto informata na duhen për procedim të mëtutjeshëm.

Frashër Krasniqi, propozoi që pas një jave të mbajmë një mbledhje të komisionit, ku do t'i ftojme edhe banorët e kësaj pjese, edhe një përfaqësues të komunës dhe të shohim si është situata, sepse është miratimi i buxhetit afër dhe duhet të shohim si të veprohet.

Kryetarja, konstatoi se në mbledhjen e radhës së komisionit, të ftohen përfaqësuesit e peticionit të fshatrave të Orllanit dhe një përfaqësues të Komunës së Podujevës nga Drejtoria për Shërbime Publike.

Shqyrtimi i shkresës së znj. Drita Hajdari

Kryetarja, tha se kemi edhe shkresën e znj. Drita Hajdari, e cila iu ka drejtuar Avokatit të Popullit me një ankesë, po që nuk iu ka përgjigjur lidhur me ankesën e bërë.

Frashër Krasniqi, tha se do të ishte mirë të ftohet Avokati i Popullit lidhur me këtë çështje, e pastaj të shohim si do të veprojmë si komision.

Kryetarja, tha se do të kontaktoj me znj. Hajdari, të shohim a ka marrë përgjigje gjatë kësaj periudhe, dhe varësisht nga përgjigja, këtë kërkesë të znj. Hajdari do ta shqyrtojmë edhe në mbledhjen e radhës.

Selman Ymeri, koordinator i komisionit, sqaroi procedurën e shqyrtimit të peticionit, në pajtim me Rregulloren e Kuvendit.

Mytaher Haskuka, tha se patëm punuar në një udhëzues për peticione, por që nuk ka kaluar. Ai theksoi se kemi peticione nën 10000 mijë nënshkrime, dhe me mbi 10000 mijë nënshkrime dhe dihet se me mbi 10000 mijë nënshkrime mund të iniciohet edhe procedura për ndryshimin e ligjit. Kemi peticione individuale dhe me disa nënshkrime, kemi raste kur peticioni nuk është mirë i qartësuar, nuk ka ndonjë kërkesë konkrete, dhe në raste të tilla as komisioni nuk di si të veprojë me atë lëndë. Këto raste, me sa e di, kanë qenë të trajtuara në atë udhëzues.

Kryetarja, propozoi që për shqyrtimin e peticioneve të caktojë një grup punues, në kuadër të Komisionit funksional, gjë që do të lehtësonte punën e komisionit lidhur me shqyrtimin e të gjitha peticioneve, të cilat i drejtohen komisionit.

Kryetarja, me pajtimin e anëtarëve të komisionit, konstatoi se formohet grupi punues për shqyrtimin e peticioneve, në këtë përbërje:

Duda Balje, Frashër Krasniqi, Mexhide Mjaku-Topalli dhe Mirjeta Kalludra.

5. Takim i anëtarëve të Komisionit funksional me përfaqësues të organizatës - Qendra për Fuqizimin e Gruas

Duda Balje, tha se për këtë pikë të rendit të ditës kemi prezent përfaqësuesen nga Qendra për Fuqizimin e Gruas, e cila do t'i parashtojë kërkesat eventuale, që kanë ndaj komisionit.

Merita Mustafa, falënderoi komisionin për mundësinë e dhënë. Qëllimi i takimit janë ngecjet në zbatimin e Ligjit për familjen. Ky ligj parasheh të drejtën për alimentacion, sikurse për gruan, ashtu edhe për fëmijët, gjithashtu edhe të drejtën e pronës, gjatë divorcit.

Problemet shkaktohen kryesisht nga mosnjohja e të drejtave të grave, pastaj mungesës së mekanizmave direkt për t'i ndihmuar ato, si dhe mungesës së zbatimit të ligjeve që zakonisht ngecin në gjykata.

Gjykatat janë të stërngarkuara me shumë lëndë, pavarësisht që ligji e thotë që lëndët për alimentacion duhet të trajtohen me prioritet, ndërsa gjykatat nganjëherë i trajtojnë njëjtë sikurse lëndët tjera. Kjo është shqetësuese, pasi që fëmijët nuk mund të presin për ushqim.

Andaj, kërkojmë nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut që të na ofrojë mbështetje, që të bëjmë rekomandime, qoftë ndonjë udhëzim administrativ për zbatimin e Ligjit për familjen, veçanërisht në këto nene, nenin për alimentacionin dhe ndarjen e pronës.

Ajo për anëtarët e komisionit kishte sjellë edhe një broshurë, me raste të tilla, ku kemi intervistuar gratë dhe secila ka përshkruar rastin e vet, në mënyrë anonime. Ka raste kur një grua 14 vjet ka pritur për të drejtën e pronës, ka raste 6 vjet, ka raste që kurrë nuk e ka marrë pronën. Ligji na i garanton këto të drejta, por kemi problem me zbatim.

Lirije Kajtazi, meqë jeni marrë konkretisht me këtë punë, a mundeni të na i specifikoni çka mund të bëjmë te kjo fushë? Të amendamentohet ligji, ku konkretisht ligji përmban gjithçka, por neglizhohet nga gjykatat.

Merita Mustafa, tek alimentacioni, ligji shumë mirë e cek, që këto lëndë duhet të trajtohen me prioritet dhe për këtë kemi propozuar që të caktohet një afat kohor, se sa do të jetë ky afat maksimumi për t'u trajtuar. Është mirë që ju të kërkonit një ekspert, i cili e analizon pak më mirë ligjin, te lënda e pronësisë, ku është më problematike, sepse kërkon ndryshim të ligjit apo të përfshihet një nen në ligjin e familjes.

Frashër Krasniqi, tek e drejta e pronës, jo vetëm te ne, por te shumë vende, elementi i pabarazisë gjinore vjen në shprehje. Tha se është dakord që të bëhet një grup punues edhe me ekspertë dhe organizata që merren me barazi gjinore, i cili grup do të kishte prioritet mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, si dhe propozimin për amendamentim të ligjit.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se nëpër shumë tryeza ku është diskutuar ky ligj, është diskutuar edhe çështja e alimentacionit.

Nëpër disa komuna, është ndarë buxhet për që t'ju ndihmohet grave për çështje që kanë qenë me interes për to. Ekzistojnë zyrat për ndihmë juridike falas nëpër disa komuna dhe kjo është e mirë për ato që nuk kanë buxhet.

Ligji për familjen, nuk është në fushën e komisionit tonë, por do t'i shohim mundësitë dhe mënyrat sesi do të veprohet për ndryshimin e këtij ligji.

Lidhur me çështje, do të bëjmë edhe pyetje parlamentare dhe do të jemi në kontakt me të gjithë aktorët e mundshëm në lidhje me këtë ligj.

Kryetarja, tha se do të kontaktojmë edhe me Komisionin për Legjislacion, pasi që ligji është kompetencë e atij komisioni.

Mytaher Haskuka, propozoi që vitin e ardhshëm, të bëhet monitorimi i Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi dhe të dalim me rekomandime konkrete, por edhe për ato ligje që kanë të bëjnë me trashëgiminë, pronën alimentacionin, dhe të tjera, të insistohet që këto çështje të rregullohen njëherë e përgjithmonë.

Albulena Balaj, tha se mos të zgjerohemi në fusha të shumta, ajo që është urgjente të insistojmë që të rregullohen afatet kohore, si ajo e alimentacionit. Do të mbështesim çdo grua, çdo organizatë që merret me mbrojtjen e të drejtave të grave.

Kryetarja, tha se do ta ftojë Agjencinë për Barazi Gjinore, do të kontraktojmë edhe me ministrin e Drejtësisë dhe do të shohim se si mund të bëhet ndryshimi i Ligjit për familjen.

6. Të ndryshme

Duda Balje, tha se kemi pranuar një kërkesë nga UNICEF-i, lidhur me shënimin e Ditës së Fëmijëve, ku kërkohet mbajtja e një seance në Kuvend, të udhëhequr nga fëmijët.

Florije Kryeziu, UNICEF, tha se 20 nëntori është Dita e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, ku nga viti 1989 njihen të drejtat e tyre.

Viteve të kaluara e kemi organizuar këtë ngjarje në bashkëpunim me kabinetin e kryetarit të Kuvendit, por kësaj radhe është mirë që të angazhohet edhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut, që është komision më relevant, rreth shënimit të kësaj dite.

Lirije Kajtazi, është mirë që të gjitha aktivitete të mbahen të koordinuara me komisionin tonë dhe kryeparlamentarit, në mënyrë që të koordinohen këto aktivitete dhe mos të jenë të ndara. Jemi të gatshëm që si komision të kontribuojmë për mbajtjen e kësaj seance.

Luljeta Veselaj, theksoi se përkrah idenë e mbajtjes së kësaj seance dhe u angazhua lidhur me çështjet organizative për realizimin e kësaj seance.

Mexhide Mjaku-Topalli, u interesua të dijë lidhur me përfshirjen e fëmijëve nga të gjitha qytetet lidhur me këtë ngjarje.

Ajo, më pas foli edhe lidhur me zbatimin e udhëzuesit nëpër shkolla për zbatimin e rregullores për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para universitar. Sipas saj, duhet të diskutohet për këtë temë apo të takojmë ministrin e Arsimit dhe në atë takim të ftohen edhe drejtorët komunalë të arsimit.

Flora Kryeziu, theksoi se sivjet do të kemi një përfaqësim të mirë të fëmijëve.

Frashër Krasniqi, tha se është që seanca për fëmijët të mbahet.

Mirjeta Kalludra, tha se të kihet parasysh se muaji nëntor mos po bëhet shumë i ngarkuar dhe disa pika mundemi mund të barten edhe në muajin dhjetor, por seanca e fëmijëve gjithsesi të mbahet dhe të dihet agjenda e kësaj seance paraprakisht.

Kryetarja, tha se do të bashkërendojmë çështjet organizative me zyrën e kryeparlamentarit për mbajtjen e seancës së udhëhequr nga fëmijët.

Frashër Krasniqi, propozoi që si pikë e rendit të ditës të jetë çështja lidhur me faturat e energjisë elektrike ku qytetarët paguajnë faturat e pjesës veriore.

Kryetarja konstatoi se kjo çështje do të jetë pikë diskutimi në mbledhjet e radhës së komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Duda Balje